



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
REKTORI

Nr. 123 .....Prot

Vlorë më, 21.01.2019

**UDHËZIM**

**Nr. 1 datë 21. 01. 2019**

"Për organizimin e punës për prezantimin e draft - "Pakti per Universitetin" si dhe vjeljen dhe evidentimin e sugjerimeve, ideve dhe propozimeve nga studentët dhe personeli akademik i UV-së, në funksion të përmirësimit te tij" .

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 39 të ligjit 80/2015,

**UDHËZOJ:**

1. Draft "Pakti për Universitetin", njoftuar nga qeveria shqiptare më datë 18. 01. 2019, të përcillet për njohje, konsultime, komentime dhe sugjerime gjithe studenteve dhe Asambleve të Personelit Akademik të UV-së, sipas fakulteteve.
2. Draft "Pakti per Universitetin", të përcillet, për njohje, konsultime, komentime dhe sugjerime: Rektoratit, Senatit Akademik, Bordit të Administrimi, Zvrektoëve, Dekanëve dhe zvdekanëve, përgjegjësive të departamenteve, përgjegjësive të grupeve mësimore të cdo fakulteti.
3. Draft "Pakti per Universitetin", të përcillet në të gjitha kryesekretaritetë, sekretaritetë mësimore dhe zyrat e informimit të studentëve të çdo fakulteti. Këto të fundit t'ia dergojnë atë në formë elektronike çdo studenti dhe të asistojnë në pyetjet dhe interesimet e tyre lidhur me këtë dokument.
4. Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve të organizojnë dhe kontrollojnë procesin e njohjes së studentëve dhe asambleve të personelit akademik me draft-dokumentin "Pakti per Universitetin".
5. Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve të organizojnë dhe kontrollojnë procesin e evidentimit të sugjerimeve, ideve dhe propozimeve, përmes konsultave, takimeve dhe kontakteve direkte me studentët dhe personelin akademik të UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**REKTORI**

6. Mbledhjet e departamenteve për këtë çështje, të zhvillohen me procesverbal të rregullt dhe vërejtjet, sugjerimet, propozimet e studentëve (më vete) dhe pedagogëve (më vete) t'i dërgohen rektorit me shkresa zyrtare si dhe në formë elektronike.
7. Mbledhjet e dekanateve për këtë çështje, të zhvillohen me procesverbal të rregullt dhe vërejtjet, sugjerimet, propozimet e studentëve (më vete) dhe asambleve të personelit akademik (më vete) të fakultetit t'i dërgohen rektorit me shkresa zyrtare dhe në formë elektronike.
8. Pas diskutimit në Rektorat, sugjerimet e studentëve dhe APA të fakulteteve përcillen në SA dhe BA, për njohje, shqyrtim dhe plotësim të mëtejshëm.
9. Materiali përfundimtar me sugjerimet dhe propozimet e studenteve dhe APA të UV-së, i analizuar nga SA dhe BA, i përcillet MASR në afatin që ajo do të përcaktojë.
10. Afati përfundimtar për dorëzim tek Rektori të relacioneve të mbledhjeve të departamenteve dhe dekanateve për këtë çështje është data 05.02.2019.
11. Dy zëvendësrektorët të ndjekin, të asistojnë dhe të kontrollojnë në përditshmëri procesin e vjeljes së sugjerime të studentëve dhe APA të fakulteteve dhe të raportojnë për çdo problematikë tek rektori.
12. Drejtoritë dhe sektorët ndihmësakademikë me karakter mësimorë dhe administrativë (në rektorat dhe njësi kryesore) të vihen në dispozicion të studentëve dhe APA së fakulteteve, në funksion të mbarëvajtjes së të këtij procesi.

**REKTORI**  
**Prof. Dr. Roland ZIST**